



RAPORT TEKNIK

Mbështetja financiare për fëmijët jashtë shkolle si një instrument për regjistrimin e tyre në shkollë- sa, çfarë dhe si.

Dr. Blendi Gerdoçi

Dhjetor, 2018



© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori)

Rr. "Blv. Bajram Curri" Nd. 136, H. 14, Ap. 1

Njësia Administrative Nr 5, 1019, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00355 42 258 987

Email: info@observator.org.al

Ëebmail: www.observator.org.al

Kjo analizë është realizuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, falë vëmendjes dhe mbështetjes së zyrës së UNICEF-it në Shqipëri, në kuadër të projektit "Leave No One Behind" ("Askush të mos Mbetet Pas"), një Program i përbashkët i OKB-së i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensi të OKB: UNDP, UNFPA, UNICEF, dhe UN WOMEN në partneritet me Qeverinë Shqiptare. Ky projekt synon fuqizimin e personave vulnerabël në Shqipëri që të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të kenë një zë në vendimmarrjen publike, që ndikon në jetën e tyre dhe t'i kërkojnë llogari zyrtarëve publikë, duke i mbajtur përgjegjës për dështimet apo arritjet.

EKSPERT I ANALIZËS

Dr. Blendi Gërdoçi

EKIPI MENAXHUES

Elma Tërshana

Eridjona Vallja

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e Observatorit. Opinionet e shprehura këtu janë të autorëve/eve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNICEF Shqipëri.

Tabela e Përmbajtjes

Falenderime.....	6
Hyrje	7
Qëllimet e Analizës	7
Qëllimi specifik	7
Qëllimi i përgjithshëm	7
Supozime të rëndësishme të qëllimit të kërkimit.....	7
Pyetje kërkimore	8
Metodologjia	8
Kufizime.....	9
Rishikim i literaturës.....	10
Kuari ligjor dhe strategjitë kombëtare për parandalimin e braktisjes	10
Faktorët që ndikojnë në braktisjen e shkollës	11
Mbështetja financiare si faktor nxitës për frekuentimin e shkollës.....	11
Përtej diskutimit mbi koston - rëndësia dhe efektet e arsimimit	12
Fenomeni i braktisjes së shkollës në Shqipëri	12
Mbështetja ekonomike dhe ofrimi i shërbimeve për fëmijët dhe familjet e tyre në Shqipëri	15
Ndihma ekonomike	15
Kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike.....	15
Masa e ndihmës ekonomike	16
Ndihma ekonomike për shkollimin e fëmijëve.....	16
Kushtëzimet.....	17
Mbështetje me shërbime.....	18
Shpenzime transporti	18
Metoda alternative për përcaktimin e ndihmës ndaj familjeve në nevojë dhe fëmijëve.....	19
Minimumi jetik dhe skemat e ndihmës ekonomike	19
Llogaritja e minimumit jetik - studim i ACER, 2016.....	20
Metoda të tjera të orientuara nga logjika e kostove.....	22
Bursat.....	22
Mbështetja për familjet në nevojë dhe fëmijët - eksperiencia nga vende të BE-së	26
Masa e ndihmës dhe kushtëzimet - raste nga vendet e BE-së.....	26
Eksperiencia të mbështetjes financiare përmes projekteve.....	27

Analizë e alternativave.....	29
Konkluzione dhe rekomandime	31
Konkluzione	31
Rekomandime.....	31
Referenca	34

Lista e shkurtimeve

ACER	Albania Center for Economic Research
ASHMDF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
BE	Bashkimi Evropian
FAO	Food and Agricultural Organization
INSTAT	Instituti i Statistikës
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
NjMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
Observatori	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Lista e Figurave

Figura 1: Braktisja e arsimit bazë në terma absolute	13
Figura 2: Braktisja e arsimit bazë sipas gjinisë.....	13
Figura 3: Braktisja e arsimit bazë në terma relative	14
Figura 4: Braktisja e arsimit bazë në terma relative	14

Lista e Tabelave

Tabela 1. Minimumi jetik në vlerë për artikujt ushqimorë në muaj	20
Tabela 2. Shpenzimet mesatare mujore për konsum	21
Tabela 3. Minimumi jetik në vlerë për frymë në muaj	21
Tabela 4. Masa e bursës për nxënësit në ALL - viti mësimor 2017-2018.....	23
Tabela 5. Kosto financiare për ushqimin e nxënësve për frymë në ditë	23
Tabela 6. Kriteret të papërfshira në analizë	29
Tabela 7. Krahasim mes dy qasjeve - minimumi jetik dhe bursat	30

Lista e Kutive

Kutia 1: Të dhëna për fëmijët që duhen rregjistruar në shkollë.....	15
Kutia 2: Kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike	16
Kutia 3: Kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike	16
Kutia 4: Masa shtesë së ndihmës ekonomike për shkollimin e fëmijëve	16
Kutia 5: Kushtëzime të ndihmës për shkollim	17
Kutia 6: Kushtëzime të ndihmës ekonomike	17
Kutia 7: Shërbime për nxënësit - transporti për në shkollë.....	18
Kutia 8: Masa e ndihmës për nxënësit për transportin publik	18
Kutia 9: KLSH mbi masën e ndihmës ekonomike.....	19
Kutia 10: Kriteret për përfitimin e bursave.....	22

Kutia 11: Llogaritja e bursave.....	24
Kutia 12: Kriteret e bursave.....	24
Kutia 11: Roli dhe përgjegjësitë e institucioneve për bursat	25
Kutia 13: Përqindjes e ndihmës ekonomike ndaj minimumit jetik të garantuar.....	27

Falenderime

Autori falenderon ekspertin e MASR, Z. Floriand Nurçe për kontributin e tij gjatë gjithë procesit të diskutimit dhe hartimit të raportit, si dhe për aksesin në të dhëna, raporte dhe analiza. Falënderimet më të sinqerta shkojnë për Znj. Mirlinda Bushati, eksperte e arsimit në zyrën e UNICEF Shqipëri, si edhe bashkëpunëtorët e Observatorit, Znj. Elma Tershana dhe Znj. Eridjona Vallja për kontributin e tyre në hartimin e këtij raporti.

Së fundi, falenderime dhe mirënjohje për mbështetjen nga punonjës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kolegë dhe miq për ndihmën e ofruar në grumbullimin e të dhënave dhe diskutimin e çështjeve të ndryshme të këtij raporti.

Hyrje

Braktisja e shkollës është një fenomen shqetësues në vendin tonë. Faktorët ndikues janë të shumëllojshëm dhe shtrihen në nivel shkollë, familje dhe komuniteti. Studime të shumta dhe eksperiencia në terren e shumë organizatave lokale, kombëtare dhe donatorëve ndërkombëtarë sugjerojnë kushtet ekonomike si një ndër shkaqet e këtij fenomeni.

Institucionet e vendit, në nivel lokal dhe kombëtar, si dhe donatorë dhe organizata të ndryshme po zbatojnë politika dhe kanë ndërmarrë iniciativa të ndryshme për zbutjen e fenomenit të braktisjes së shkollës. Në këtë kuadër, Observatori në bashkëpunim me UNICEF dhe MASR kanë ndërmarrë disa projekte. Së fundmi, këto institucione në bashkërendim me Bashkinë Durrës kanë mbështetur financiarisht familjet e disa fëmijëve jashtë shkollë. Rezultatet janë inkurajuese dhe kanë nxitur Observatorin të fokusohet në çështjen e masës së mbështetjes financiare për familjet në nevojë me qëllim zbutjen e fenomenit të braktisjes së shkollës nga ana e fëmijëve që vijnë nga familje të tilla.

Qëllimet e Analizës

Qëllimi specifik

Qëllimi specifik i kësaj analize është përcaktimi i një intervali vlere, apo reference të orientuar nga një logjikë kostoje¹, e cila mundëson përballimin e shpenzimeve bazë nga një familje për një fëmijë përfshirë shkollimin e tij/saj.

Për të kuptuar më mirë qëllimin e kërkimit dhe kontekstin në të cilin realizohet, është e nevojshme të kuptohet qëllimi i përgjithshëm i tij, ose thënë, arsyeja e realizimit të kësaj analize.

Qëllimi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm lidhet me parashtrimin e disa rekomandimeve për politike-bërje që synojnë përfshirjen e fëmijëve jashtë shkollë², ose atyre kanë braktisur shkollën në sistemin shkollor të detyrueshëm përmes pilotimit të një mbështetje financiare për familjet e këtyre fëmijëve në nivel lokal, apo eventualisht, kombëtar.

Supozime të rëndësishme të qëllimit të kërkimit

Një implikim i rëndësishëm i qëllimit të përgjithshëm të kërkimit është supozimi bazë mbi të cilin është ndërtuar - mbështetja financiare për familjet do ndikojë pozitivisht në kthimin/përfshirjen e fëmijëve në shkollë. Për të kuptuar vlefshmërinë e këtij supozimi së pari, është e nevojshme të shfletohet literatura, e cila na njeh me eksperiencia në kontekste të ndryshme. Se dyti, mund të testohet nëse ka evidencë empirike në vendin tonë për t'a mbështetur një supozim të tillë.

¹ Sqarim termash: Në këtë analizë dhe në kontekstin në fjalë, me kosto do kuptojmë shpenzimet që realizon familja për të përballuar nevojat bazë të mbijetesës dhe shkollimit të një fëmije.

² Sqarim termash: Me fëmijë jashtë shkollë kuptojmë fëmijët që nuk frekuentojnë sistemin e detyrueshëm arsimor.

Një supozim tjetër, shfaqet kur konsiderojmë lidhjen që ekziston mes qëllimit specifik të kërkimit dhe atij të përgjithshëm - 'analiza e kostos' së një fëmijë jashtë shkolle është baza mbi të cilin mund të përcaktohet një mbështetje financiare për familjet e fëmijeve që nuk frekuentojnë ose kanë braktisur shkollën. Me të njëjtin arsyetim, sugjerohet në mënyrë implicite, se përveç këtyre kostove duhet të konsiderohen edhe kostot që duhet të përballojnë familjet për të mbajtur një fëmijë në shkollë. Ky supozim i rëndësishëm kërkon shfletimin e literaturës rreth bazës konceptuale dhe metodave për llogaritjen e një mbështetje financiare të aplikuara në vende të tjera duke adresuar pyetjen - a është kostoja si më lart konceptuar, baza për llogaritjen e mbështetjes financiare? Cilat janë politikat dhe praktikrat që aplikohen në vendin tonë? Cilat janë praktikrat më të mira të llogaritjes së kësaj mase, mekanizmat e disbursimit dhe parakushtet për efektivitet të aplikimit të një mase ndihme?

Pyetje kërkimore

Mbështetur në sa më sipër, lidhur me supozimet dhe implikimet që lindin nga qëllimi specifik dhe ai i përgjithshëm i kësaj analize, si dhe duke konsideruar kontekstin e analizës janë ndërtuar pyetjet e mëposhtme kërkimore:

- Cilat janë politikat dhe më konkretisht, skemat e mbështetjes financiare dhe shërbimet e aplikuara nga agjensi dhe institucione qeveritare në vendin tonë, në ndihmë të familjeve dhe nxënësve?
- Cilat janë politikat dhe skemat e mbështetjes financiare të aplikuara nga agjensi dhe institucione qeveritare të vendeve të ngjashme me Shqipërinë, si dhe ato më të avancuara në drejtim të politikave sociale, në ndihmë të familjeve dhe nxënësve?
- A ka ndryshime të rëndësishme mes vendeve të tjera dhe Shqipërisë, të cilat shkojnë në drejtim të nxitjes së frekuentimit të shkollës?
- Cila është logjika mbi të cilën ndërtohet mbështetja financiare? A ka llogaritje të mbështetjes financiare të orientuar nga logjika e kostos?
- Cilat prej modeleve do ishte më e përshtatshme për tu aplikuar në mënyrë që të zbutet fenomeni i braktisjes së shkollës?
- Cilat institucione dhe me çfarë modalitetesh mund të aplikojnë modele të tilla?

Metodologjia

Studime të ndryshme sugjerojnë tre dimensione të rëndësishme në lidhje me mbështetjen financiare: (1) masa e mbështetjes financiare; (2) kushtëzimet për t'a aksesuar dhe (3) monitorimin e efikasitetit të instrumenteve të tillë (EU, 2015). Që këtu, analiza që vijon ka në qendër të objektit të studimit të saj pikërisht këto dimensione. Pra në menyrë specifike, analiza duhet të trajtojë: 1) përcaktimin e një reference ose intervali të mbështetjes financiare për familjet në nevojë me fokus frekuentimin nga ana e fëmijëve të tyre të shkollës, 2) arsyetim mbi kushtëzime që duhen aplikuar për mbështetjen financiare në mënyrë që kjo e fundit të jetë efektive si nxitës për frekuentimin e shkollës dhe (3) arsyetim mbi matjen (për sa është e mundur) të efikasitetit të këtij instrumenti.

Përcaktimi në terma sasiore të një mbështetje financiare për familjet e fëmijëve që kanë braktisur shkollën nga pikëpamja metodologjike mund të mbështetet në (1) *proxy*³ që rezulton nga analiza të tjera të mbështetura në logjikën e kostos, ose/dhe (2) në metodat/praktikat më të mira të vendeve të tjera. Metodologjikisht, arsyetimi mbështetet kyesisht në analizimin krahasues të të dhënave dytësore të mbledhura përmes rishikimit të literaturës, raporteve, ligjeve, rregulloreve, etj.

Çështja e kushtëzimeve do trajtohet po ashtu, përmes një analize krahasuese. Nga njëra anë, do analizohen llojet e kushtëzimeve që aplikohen në vendin tonë. Nga ana tjetër, do trajtohen eksperiencat nga vendet BE-sësi Bullgaria, apo vende të tjera, që paraqesin ngjashmëri me Shqipërinë.

Matja e efikasitetit të mbështetjes financiare mund të realizohet përmes analizimit të rezultateve të projektit pilot të “Mekanizmit financiar për mbështetjen e nxënësve jashtë shkolle dhe atyre në rrezik për braktisjen e shkollës” e zbatuar në Bashkinë Durrës (Ciko, 2017). Qartazi, një analizë e tillë është mjaft e kufizuar në forcë përgjithësuese meqenëse numri i përfituesve është mjaft i vogël (vetëm 3). Kjo evidencë është ndihmëse për të kuptuar efektin e mbështetjes financiare dhe procedurave të aplikuara në monitorim.

Meqenëse qëllimi i përgjithshëm i kësaj analize është parashtrimi i rekomandimeve për politikëbërje, lind nevoja për vlerësimin e alternativave të ndryshme mbi të cilat mund të mbështetet masa dhe modalitetet e zbatimit të një politike në mbështetje të fëmijëve jashtë shkolle, ose atyre që kanë braktisur shkollën. Për vlerësimin e alternativave në terma të politikës apo masës së mbështetjes janë përdorur një sërë kriteresh: (1) fizibiliteti administrativ, (2) kosto-efektiviteti, (3) eficaenca ekonomike dhe (4) qëndrueshmëria. Këto kritere janë përshtatur nga literatura (p.sh., IOB, 2009) dhe janë përzgjedhur mes të tjerëve mbështetur në mundësitë dhe burimet e studimit dhe vlefshmërinë e të dhënave.

Gjetjet e këtyre analizave janë integruar me njëra tjetrën, diskutuar me ekspertë të fushës dhe validuar në funksion të përpilimit të disa rekomandime për politikë-bërje.

Kufizime

Ky raport teknik me qëllim parashtrimin e disa rekomandimeve për politikë-bërje, qoftë edhe në trajtën e projekteve me natyrë të kufizuar lokale, ka disa kufizime të rëndësishme.

Së pari, ky raport nuk merr përsipër të përgjithësojë mbi efektin e pritshëm të rekomandimeve në politikë-bërje, apo kosto-efektivitetit të këtyre rekomandimeve për arsye të të qenurit i pjesshëm në qasje analitike, metodologjikisht i kufizuar dhe i mbështetur vetëm në evidencë anekdotike për sa i përket efektit. Literatura sugjeron qasje më gjithëpërfshirëse në analizimin e fenomenit të braktisjes së shkollës dhe të politikave që mund t'a zvogëlojnë atë. Si hap i parë, për të pasur një pamje të qartë dhe të plotë të rolit të faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në braktisjen e shkollës, strategjia kërkimore më e zakonshme ështëurvejimi i të gjithë aktorëve - prindërit, fëmijët, mësuesit, drejtuesit e bordeve të prindërve, etj, duke konsideruar dimensionet si: karakteristikat specifike të tyre, standartet, perceptimet, marrëdhëniet mes aktorëve, strategji motivimi që çojnë në frekuentimin e shkollës, etj (UNICEF, 2012). Përmes një qasje të tillë mund të krijohet një

³ Në këtë rast, një shumë që përfaqëson vlerën/madhësinë që duam të masim

panoramë më e qartë të rolit të faktorëve të ndryshëm, si dhe mund të rekomandohen politika me rreze më të gjerë veprimi dhe efikasitet më të lartë. Më tej, mund të parashikohet kostoja dhe efekti i prituri i këtyre rekomandimeve për politikë-bërje, apo të përdoren metoda të tjera shumë-kritereshe. Si rezultat, rekomandimet e parashtruara të dala nga analiza mund të konsiderohen si një bazë mbështetëse fillestare për përpilimin e projekteve pilot, apo ndërmarrjen e analizave/studimeve të tjera më të thelluara në terma impakti të pritshëm.

Së dyti, ky raport nuk paraqet argumente në lidhje me mënyrën e implementimit të mekanizmit të mbështetjes, e cila rezulton të jetë mjaft e rëndësishme (shih më lart). Në këtë raport nuk gjenden analiza të kompetencave të institucioneve të ndryshme, si dhe nuk janë analizuar procedurat që aplikohen apo që potencialisht mund të aplikohen. Edhe pse do analizohen mekanizma të instrumentave të ngjashëm të ndihmës financiare, mënyra e implementimit kërkon vëmendje të veçantë në momentin kur të ndërmerret një iniciativë e tillë.

Së treti, duke qenë se analiza është e kufizuar në burime, metodologjia e përzgjedhur ka konsideruar si kriter primar kosto-efektivitetin. Si rezultat, ky raport paraqet disa kufizime me natyrë metodologjike. Për shembull, në pamundësi për një vlerësim rigoroz të alternativave janë përdorur vetëm katër nga tetë deri në dhjetë (apo më shumë në disa raste) kriteret e sugjeruara nga literatura. Në mjaft raste, në mungesë të të dhënave janë përdorur sugjerime të ekspertëve të fushës, apo thjesht, logjika deduktive.

Së katërti, ky raport jep orientime lidhur vetëm për ndërtimin e një mase mbështetje financiare që synon regjistrimin e nxënësve në shkollë. Një politikë efektive duhet të konsiderojë dhe kostot apo masat e mbajtjes së fëmijëve në shkollë përmes dizenjimit dhe zbatimit të instrumenteve për identifikimin e hershëm dhe ndërhyrjen e shpejtë në rast braktisje. Që këtu, konkluzionet lidhen më shumë me trajtimin e problemit përmes një instrumenti të vetëm, sesa parandalimin e tij.

Rishikim i literaturës

Kuadri ligjor dhe strategjitë kombëtare për parandalimin e braktisjes

Sipas Ligjit Nr. 48/2018 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 22 pika 4 dhe pika 5, përcaktohet sa vijon:

4. Arsimi bazë me kohë të plotë është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët që janë shtetas shqiptarë me banim në Republikën e Shqipërisë nga moshja gjashtë vjeç deri në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj. Nxënësi ka të drejtë ta ndjekë arsimin bazë me kohë të plotë deri në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç. Nxënësi, që ka mbushur moshën shtatëmbëdhjetë vjeç dhe nuk ka përfunduar arsimin bazë, lejohet të përfundojë klasën që po ndjek. Nxënësit, që kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk e kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë, kanë të drejtë të regjistrohen në shkollat e arsimit bazë me kohë të pjesshme.

5. Nxënësi, që nuk ka ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë me kohë të plotë, ka të drejtë ta ndjekë arsimin bazë me program mësimor individual, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

Si rezultat, është e domosdoshme krijimi i mekanizmave për angazhimin e të gjithë fëmijëve në shkollë, ndaj dhe një ndër prioritetet e Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020 është Gjithëpërfshirja dhe në një masë konkrete (B2.3, f.42) parashikohet parandalimi i braktisjes, sipas të cilës kërkohet të “ndërtohet një filozofi e re e gjithëpërfshirjes dhe vihet në zbatim marrëveshja tre ministrove për identifikimin dhe përfshirjen e fëmijëve jashtë shkolle në sistem.” Sipas kësaj marrëveshje “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor” dhe rregullores përkatëse, institucione të ndryshme si strukturat e varësisë të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin (njësitë arsimore vendore dhe shkollat), Ministria e Brendshme, Komisaritetet e Policisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, qendrat shëndetësore, pushteti lokal dhe qendrat e specializuara, kanë detyra të caktuara për identifikimin e fëmijëve larg shkollës dhe regjistrimin e tyre. Gjithashtu, gjatë viteve të shkollës, institucionet shkollore, ndërmarrin nisma për parandalimin e braktisjes dhe mbajtjen e nxënësve në shkollë.

Faktorët që ndikojnë në braktisjen e shkollës

Studimet në lidhje me faktorët që ndikojnë në braktisjen e shkollës nga fëmijët parashtrajnë tre perspektiva kryesore përmes të cilave mund të hulumtohet ky fenomen - familjes, shkollës dhe komunitetit (Unicef, 2012). Perspektiva e familjes ndihmon në identifikimin e disa faktorëve që ndikojnë në fenomenin në fjalë, si psh, problemet familjare, vështirësitë ekonomike, punësimi i fëmijëve, shëndeti i dobët i tyre, përshtypja jo-pozitive për shkollën, etj. Perspektiva e shkollës ndikon në identifikimin e faktorëve të tjerë si kostot e larta të edukimit, cilësia e dobët e tij, distanca dhe aksesit, diskriminimi, etj. Së fundmi, hulumtimi i problemit përmes perspektivës së komunitetit mundëson identifikimin e disa faktorëve të tjerë si mungesë vëmendje ndaj problemit të braktisjes së shkollës, paragjykimet në lidhje me rolet sociale, probleme të natyrës administrative, etj (Unicef, 2012).

Studimet që përdorin këtë qasje shumë-dimencionale dhe gjithëpërfshirëse parashtrajnë dhe një tërësi rekomandimesh në nivel politike-bërje, por jo vetëm, të cilat qartësojnë rolin dhe veprimet/iniciativat që duhet të ndërmarrin të gjithë aktorët e përfshirë, qofshin këto komunitete, shkolla, familje, qeverisje lokale dhe qendrore, etj (Unicef, 2012). Një ndër iniciativat e sugjeruara lidhet pikërisht me mbështetjen financiare të familjeve. Megjithatë, të tilla mbështetje shihen si ngushtësisht të lidhura me ndërhyrje të tjera, si dhe të kushtëzuara prej tyre.

Mbështetja financiare si faktor nxitës për frekuentimin e shkollës

Shumë vende të botës përdorin transferta të kushtëzuara parash për të ndihmuar familjet në nevojë, si dhe për të reduktuar fenomenin e braktisjes së shkollës. Megjithatë, evidencat e efektivitetit të këtij instrumenti janë të kufizuara. Së pari, përdorimi i transfertave të kushtëzuara është efikas vetëm atëherë kur problemet dhe dobësitë në aspektin e ofertës (psh., kushtet dhe cilësia e shkollave dhe edukimit) janë adresuar. Së dyti, kushtëzimet e skemave të tilla duhet të jenë të qarta dhe në përshtatje me disa karakteristika të grupeve të synuara (p.sh., sipas nivelit të të ardhura të familjes, situatës shëndetësore të fëmijës, të ndryshme në zona urbane dhe rurale). Së treti, skema të tilla duhen kombinuar me shërbime të tjera sociale (p.sh., mentorim i fëmijëve) në mënyrë që të arrihet një ndryshim në sjellje, si nga ana e fëmijëve, ashtu dhe familjes. Sëkatërti, implementimi dhe monitorimi i këtyre skemave duhet të jetë tejet i kujdesshëm. Verifikimi i plotësisht të kushteve për një ndihmë të tillë përmes të dhënave administrative

është një proces mjaft i vështirë. Nga ana tjetër, monitorimi i vazhdueshëm lejon përmirësimin dhe përshtatjen e skemave në varësi të kontekstit (EU, 2015).

Një skemë e mbështetjes financiare, e cila përmendet si rast suksesi është *“universal child allowance”* në Argjentinë. Skema nuk parashikon vetëm një ndihmë financiare të kushtëzuar për familjen me qëllim regjistrimin në shkollë, por shoqërohet me masa aktive të shkollës dhe aktorëve të tjerë për integrimin e fëmijëve në shkollë. Implementimi i kësaj skeme është monitoruar nga autoritetet përkatëse dhe studiues të fushës nga ku janë dokumentuar faktorë suksesi të lidhur me mënyrën e implementimit. Iniciativa jo vetëm ka ndikuar në nivelin e regjistrimeve të fëmijëve jashtëshkollë, por dhe uljen e normës së varfërisë ekstreme duke ndikuar pozitivisht tek punësimi i prindërve (Maurizio dhe Vázquez, 2014).


Përtej diskutimit mbi koston - rëndësia dhe efektet e arsimimit

Pavarësisht se kjo analizë ka si njësi analize individin dhe fokusi është tek kostoja, edukimi nuk është thjesht një çështje që mund të kufizohet kaq ngushtë. Përfitimet nga edukimi janë shumë të rëndësishme si për individin, ashtu dhe për shoqërinë. Një numër i madh studimesh kanë përdorur një këndvështrim më të gjerë duke konsideruar si kostot, ashtu dhe efektet e arsimimit. Qasjet për matjen e efekteve janë të ndryshme. Një model është ai mikroekonomik. Ky model përcakton impaktin e edukimit mbi të ardhurat shtesë dhe produktivitet që të edukuarit në shkollë kanë ndaj atyre të pa-arsimuar (Burnett, Guison-Dowdy dhe Thomas, 2013). Edhe pse fokusi është i ngjashëm, një model tjetër - ai markoekonomik, përdor seri kohore nga rajone, apo vende të ndryshme, të cilat përcaktojnë rritjen e të ardhurave në funksion të akumulimit të kapitalit njerëzor (Mincer 1974). Qartazi, përdorimi i metodave të tilla është me shumë interes në nivel politikë-bërje dhe mund të çojë në konkluzione dhe rekomandime që shkojnë përtej problemit të koston dhe mbështetjes financiare për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë.

Fenomeni i braktisjes së shkollës në Shqipëri

Braktisja e shkollës mbetet një problem i rëndësishëm në vendin tonë. Megjithatë, shifrat zyrtare të MASR tregojnë se në terma absolute, numri i nxënësve që braktisin shkollën ka rënë ndjeshëm (shih Figurën1).

Figura 1: Braktisja e arsimit bazë në terma absolute




Burimi: MASR, 2018

Sipas Unicef, edhe pse niveli i braktisjes në rang kombëtar ka rënë, në krahasim me MASR, Instituti i Statistikave (INSTAT) raporton më shumë fëmijë që nuk shkojnë në shkollë duke evidentuar si statistikat kombëtare fshehin disa pabarazi dhe pasaktësi pasi mjetet standarde për mbledhjen e të dhënave dhe procedurat e raportimit nuk janë të zhvilluara plotësisht. Gjithashtu, studime që kanë trianguluar të dhëna administrative dhe statistika zyrtare kanë arritur në përfundimin se shifrat e braktisjes janë më të larta se ato që raportohen pasi institucionet shkollore nuk deklarojnë të gjithë rastet e braktisjes për arsye të ruajtjes së treguesve të cilësisë në shkollat e tyre (Ziu, 2014).

Të dhënat e MASR tregojnë një shpërndarje pothuajse të barabartë mes gjinive për sa i përket braktisjes së shkollës (shih figurën 2). Vihet re se, nëse nga viti 2006 numri i vajzave që braktisnin shkollën ishte më i lartë se ai i djemve, trendi ka pësuar ndryshime gjatë viteve të fundit - numri i djemve është më i lartë se ai i vajzave.


Figura 2: Braktisja e arsimit bazë sipas gjinisë



Burimi: MASR, 2018

Në terma relative - numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën kundrejt numrit total të nxënësve të regjistruar- ka pësuar një ulje të ndjeshme gjatë viteve (figura 3). Ky trend zbritës është më i theksuar në periudhën 2011-2013. Në periudhën 2014 deri në 2017 vërehet një rritje relativisht e moderuar e numrit të nxënësve që kanë braktisur shkollën. Një ritje e tillë mund të lidhet me migrimin e familjeve dhe mos deklarimin pranë institucioneve arsimore.


Figura 3: Braktisja e arsimit bazë ne terma relative



Burimi: MASR, 2018

Nga pikëpamja e shpërndarjes gjeografike të fenomenit, rezulton se në ndryshim nga dekada e kaluar, fenomeni i braktisjes së shkollës është pothuajse në të njëjtat nivele si në zonat rurale, ashtu dhe ato urbane (shih figurën 4). Një studim më i detajuar në disa zona pilot (Shkodër, Tiranë, Berat) konkludoi që braktisja shkollore shënon shifra më të larta në zonat me varfëri më të lartë, tek fëmijët e komunitetit rom e egjiptian dhe në zona me terren e infrastrukturë të vështirë (Ziu, 2014; p.117).

Figura 4: Braktisja e arsimit bazënëterma relative



Burimi: MASR, 2018

Të dhënat e fundit nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHMDF) për identifikimin e fëmijëve që kanë mbushur moshën e detyrimit shkollor dhe regjistrimin e tyre në shkollë për vitin akademik 2017-2018 tregojnë se në total janë identifikuar 403 fëmijë për tu regjistruar në shkollë (kutia 1).

Kutia 1: Të dhëna për fëmijët që duhen regjistruar në shkollë

69 fëmijë që kanë braktisur shkollën;
128 fëmijët që rrezikojnë të braktisin shkollën;
11 fëmijët mbi moshën 9 vjeç që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë;
18 fëmijë me aftësi të kufizuar të cilët mbështeten nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF);
9 fëmijë të paregjistruar në gjendje civile;
168 fëmijë në situatë rruge.

Burimi: ASHMDF, 2018.

Ndër shkaqet e braktisjes apo mos frekuentimit, janë evidentuar niveli ekonomik-shoqëror i familjeve, papunësia, pabarazia rajonale e zhvillimit në kuadër vendi, prezenca e problemeve të ndryshme sociale, lëvizjet migratore të brendshme e të jashtme të popullsisë, mungesa e besimit mbi mundësitë që ofron shkolla për të ardhura më të larta, përjashtimi social i shtresave vulnerabël të shoqërisë, gjendja fizike e shkollave dhe infrastruktura, prezenca e fenomenit të gjakmarrjes, mentaliteti i një numri familjesh (të zonave rurale, periurbane dhe të minoritetit rom) mbi arsimimin e vajzave (Ziu, 2014; p.119).

Analiza e mësipërme tregon se pavarësisht se fenomeni i braktisjes së shkollës është zbutur disi në dekadën e fundit, prezenca e tij mbetet shqetësuese sidomos mes disa grupeve shoqërore më të margjinalizuara si romët, apo fëmijët që vijnë nga familje me të ardhura të pakta. Në mënyrë specifike, fëmijët rom nuk regjistrohen apo e braktisin shkollën për shkaqe si tradita migratore të familjeve, kushtet e strehimit dhe infrastrukturës, niveli i punësimit të pindërve dhe kushtet e jetesës në familje, shkalla e edukimit në familje dhe përfitimit nga shërbimi shëndetësor, vështirësia gjuhësore dhe përjashtimi social, mungesa e mbështetjes së prindërve (Ziu, 2014; p.180). Sa më sipër, masat që synojnë të regjistrojnë apo integrojnë në shkollë fëmijë nga këto grupe vulnerabël, mund të jenë efektive vetëm nëse konsiderojnë kompleksitetin e situatës dhe shkaqet e fenomenit.

Mbështetja ekonomike dhe ofrimi i shërbimeve për fëmijët dhe familjet e tyre në Shqipëri

Ndihma ekonomike

Kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike

Në Shqipëri, ashtu si në shumë vende të botës, ndihma ekonomike përbën burimin kryesor të mbështetjes financiare për familjet në nevojë, nga ku vijnë një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve jashtë shkolle, apo ata që braktisin shkollën.

Kushtet dhe kriteret për të përfituar ndihmën ekonomike përcaktohet me vendim te veçantë të Këshillit të Ministrave (VKM) (shih kutinë 2). Vendimi parashtron ekzistencën e një formule të

unifikuar, por nuk paraqet shumë detaje në lidhje me përllogaritjen e ndihmës ekonomike përmes saj.

Kutia 2: Kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike

1. Formula e unifikuar e pikëzimit përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla si: të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitanca, qiraja, asetet, bujqësia, blegtoria, trashëgimia dhe dhuratat.
 2. Treguesit e vlerësimit, pjesë e formulës së unifikuar të pikëzimit, që ndihmojnë në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë së familjeve për përfitimin e ndihmës ekonomike, përcaktohen sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
 3. Përditësimi i formulës së unifikuar të pikëzimit propozohet nga ministria përgjegjëse për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, në varësi të ndryshimeve të nivelit të varfërisë në vend, të publikuar nga INSTAT-i, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
 4. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 dhjetor 2016.

Burimi: Vendim, Nr. 956, datë 7.12.2016, për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Masa e ndihmës ekonomike

Pavarësisht rritjes së ndihmës ekonomike vitet e fundit, kjo mbështetje financiare mbetet në nivele relativisht të ulëta po të krahasohet me koston e jetesës dhe minimumin jetik (shih në seksionet e mëposhtme të raportit). Aktualisht, ndihma ekonomike nuk i kalon 8,000 ALL për familje, ndërsa anëtarët e familjes nën moshën 18 vjeç, ku bën pjesë dhe kategoria e nxënësve të arsimit bazë përfitojnë një ndihmë ekonomike prej 900 ALL (shih kutinë 3).

Kutia 3: Kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike

- [...]
2. Pavarësisht nga përbërja e saj, masa maksimale e plotë e ndihmës ekonomike për familjen nuk mund të jetë më e lartë se 8,000 (tetë mijë) lekë në muaj.
- [...]
7. Masa e ndihmës ekonomike për familje llogaritet:
 - a) 1800 (njëmijë e tetëqind) lekë për anëtarin e parë të familjes sipas renditjes në çertifikatën familjare;
 - b) 1260 (njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë për anëtarët e tjerë të familjes mbi moshën 18 vjeç;
 - c) 900 (nëntëqind) lekë për anëtarët që janë në dhe nën moshën 18 vjeç.
- [...]

Burimi: Udhëzim, Nr. 4, Datë 17.02. 2017 - "për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 9, datë 08. 05. 2017

Ndihma ekonomike për shkollimin e fëmijëve

Në bazë të VKM Nr. 955, datë 7.12.2016, familjeve të cilat kanë fëmijë në shkollë i jepet një shtesë prej 300 ALL për shkollimin (shih kutinë 4). Qartazi, qeveria përpiqet të nxisë përmes kësaj mase shkollimin e fëmijëve, pavarësisht se ndihma është relativisht e kufizuar po të konsiderohen shpenzimet e familjeve për shkollimin sikurse rezulton ngaurvejimet e INSTAT (shih më poshtë).

Kutia 4: Masa shtesë së ndihmës ekonomike për shkollimin e fëmijëve

[...]

III. MASA E NDIHMËS EKONOMIKE

1. Përlllogaritja e masës së plotë të ndihmës ekonomike, për familjet e përzgjedhura në bazë të formulës së pikëzimit, bëhet sipas strukturës së familjes, por nuk mund të jetë më e lartë se 8,000 (tetë mijë) lekë në muaj.

8. Anëtarët e familjes, fëmijë, për të cilët vërtetohet që ndjekin arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç, marrin një shtesë në masën 300 (treqind) lekë në muaj gjatë vitit shkollor.

9. Anëtarët e familjes, fëmijë, për të cilët vërtetohet se janë vaksinuar sipas kalendarit të vaksinimit, marrin një shtesë në masën 100 (njëqind) lekë, për çdo vaksinë të kryer.

[...]

Burimi: VKM Nr. 955, datë 7.12.2016, për përcaktimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike.

Kushtëzimet

Duhet theksuar se ndihma për shkollimin e fëmijëve është e kushtëzuar. Megjithatë, kushtëzimi shtrihet vetëm në pjesën e ndihmës që lidhet me shkollimin dhe jo për tërësinë e ndihmës që i jepet familjes për çdo fëmijë (shih kutinë 5).

Kutia 5: Kushtëzime të ndihmës për shkollim

4.1.3 Për fëmijët e familjeve në nevojë, që ndjekin arsimin bazë, paraqesin edhe vërtetimin për ndjekjen e shkollës të lëshuar nga shkolla, i cili është i detyrueshëm për t'u dorëzuar dy herë brenda një viti shkollor, për të përfituar pagesën shtesë.

Burimi: VKM Nr. 955, datë 7.12.2016, për përcaktimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike.

Kjo praktikë kushtëzimi të pjesshëm aplikohet për pjesën e ndihmës për shkollimin dhe ajo që lidhet me vaksinimin. Megjithatë, po ky vendim parashikon situata kur dhënia e ndihmës kushtëzohet në tërësinë e saj në rast se përfituesi nuk plotëson disa kushte (shih kutinë 6).

Kutia 6: Kushtëzime të ndihmës ekonomike

[...]

9. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë gjashtë mujore, familjet të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme:

[...]

dh) Refuzojnë përfshirjen në kurset e formimit profesional ose refuzojnë ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit;

[...]

Burimi: VKM Nr. 955, datë 7.12.2016, për përcaktimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike.

Mund të deduktohet se VKM përpiqet të nxisë sjellje të caktuara tek përftuesit e rritur përmes kushtëzimeve më të ashpra, krahasimisht me ato masa që kanë në vëmendje anëtarët e familjes nën moshën 18-vjeçare. Megjithatë, meqënëse kushtëzimi shtrihet vetëm tek shtesa për shkollimin, e cila është relativisht e vogël (vetëm 300 ALL), efektiviteti i kushtëzimit në nxitjen e frekuentimit të shkollës është relativisht i vogël. Për më tepër, për të marrë këtë përfitim, familjeve i kërkohen vërtetime periodike të statusit të fëmijës në shkollë, që përfaqëson një kosto më vete dhe shpesh nuk e justifikon përfitimin.

Mbështetje me shërbime

Shpenzime transporti

Në kuadër të politikave të mbështetjes së fëmijëve, të cilët vijnë nga familjeve që përfshihen në shtresat në nevojë, apo bëjnë pjesë në grupet e marginalizuara, MASR ofron transportin falas për nxënësit kur rezidenca e tyre është në një distancë të caktuar nga vendodhjes e shkollës.

Kushtet për përfitimin e këtij shërbimi, apo rimbursimit të shpenzimeve janë të përcaktuara me VKM. Nxënësit që vijnë nga familje në nevojë bëjnë pjesë në këtë grupin e përfituesve të kësaj mbështetje.

Kutia 7: Shërbime për nxënësit - transporti për në shkollë

1. Përballimin nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e:

[...]

b) nxënësve që ndjekin institucionet arsimore publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë, nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg institucioneve arsimore publike më të afërta (shkollë/kopsht);

Në asnjë rast nuk përfitojnë shpenzime transporti nxënësit/fëmijët që udhëtojnë mbi 2 km, nëse në vendbanimin e tyre funksionojnë institucionet arsimore publike (shkollë/kopsht).

c) nxënësve që jetojnë në qendra rezidenciale të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në institucionet arsimore publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike);

ç) nxënësve të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik.

[...]

Burimi: VKM Nr. 682, datë 29.7.2015, për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjëeve arsimore që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit

Masa e rimbursimit apo kosto e shërbimit, ndryshon në varësi të distancës. Procedurat e tenderimit të shërbimit apo rimbursimit të shpenzimeve janë të përcaktuara në të njëjtin vendim (shih kutinë 8).

Kutia 8: Masa e ndihmes për nxënësit për transportin publik

[...]

3. Njësitë arsimore vendore, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, sipas linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore ose qendrore.

Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, këto njësi realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose pranë zyrave të Postës Shqiptare, sh.a., në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi. Masa e shpenzimeve për llogaritë në bazë të numrit të nxënësve dhe të mësuesve, numrit të ditëve mësimore, çmimit mesatar të biletës për linjat ndërqytetase apo rrethqytetase të shërbimit të transportit, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, dhe të indeksimit të çmimeve të shërbimit të transportit, të botuara çdo vit nga INSTAT-i, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

[...]

Burimi: VKM Nr. 682, datë 29.7.2015, për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjëeve arsimore që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit

Kjo skemë mbështetje për shërbimet e transportit rezulton mjaft efikase në zbutjen e fenomenit të braktisjes së shkollës. Vlerësimet e MASR tregojnë që fenomeni mund të ishte potencialisht mjaft më i përhapur në mungesë të një mbështetje të tillë.

Metoda alternative për përcaktimin e ndihmës ndaj familjeve në nevojë dhe fëmijëve

Mjaft prej skemave të mbështetjes për familjet në nevojë dhe fëmijët e tyre që frekuentojnë, apo jo, shkollën janë ndërtuar mbi bazën e llogaritjeve, të cilat mbështeten mbi mundësitë e buxhetit të shtetit⁴. Duke konsideruar pamjaftueshmërinë e mbështetjes financiare, mjaft institucione dhe organizata janë duke mbështetur përdorimin e qasjeve/metodave të tjera "të orientuara nga kostot" për të përcaktuar masën e ndihmës ekonomike, pensionet, pagën minimale, etj.

Minimumi jetik dhe skemat e ndihmës ekonomike

Në legjislacionin shqiptar nuk ka ndonjë dispozitë e posaçme e cila trajton çështjen e minimumit jetik⁵ dhe si pasojë, asnjë prej treguesve të varfërisë nuk mbështetet drejtpërdrejt në treguesin e minimumit jetik. Përpjekjet e bëra për t'a përfshirë konceptin e minimumit jetik në Kodin e Punës të vitit 1995, apo përmendja e tij nëVKM, Nr. 119, datë 08.03.2001, 'Për një Shtesë Fondi në Buxhetin e Vitit 2001', të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, nuk u arritën të zhvillohen më tej drejt përpilimit të një dispozite të veçantë. Aktualisht, nuk ka një përkufizimin ligjor të tij dhe koncepti nuk aplikohet në politikat sociale. Niveli i pagës minimale, masa e ndihmës ekonomike, pagesës së papunësisë dhe pagesës së paaftësisë përcaktohen me VKM (ACER, 2016).

Tradita e përcaktimit të madhësisë së ndihmës ekonomike ka një 'logjikë buxhetore'. Duke u nisur nga një konstatim i tillë, Kontrolli i Lartëi Shtetit (KLSH) sugjeron pikërisht, aplikimin e minimumit jetik në përcaktimin e masës së ndihmës ekonomike (shih kutinë 9 më poshtë). Në mënyrë përmbledhëse raporti shprehet se *"në Shqipëri nuk ka një vlerë të miratuar nga qeveria të minimumit jetik dhe kufirit të varfërisë, mbi të cilën të bazohen politikat dhe studimet e përkujdesit social"* (KLSH, 2018).

Kutia 9: KLSH mbi masën e ndihmës ekonomike

A.Shuma e përcaktuar nga skema e Ndihmës Ekonomike nuk reflekton nevojat reale dhe aktuale të individëve dhe familjeve, duke qenë se nuk ka një vlerë zyrtare të përditësuar të minimumit jetik në Shqipëri. Njëkohësisht studimet e tjera të kryera mbi vlerën e minimumit jetik nga institucione publike nuk janë marrë dhe nuk mund të merren si shifra zyrtare, për aq kohë sa nuk janë miratuar me akte ligjore apo nënligjore. Por të mos harrojmë se masa e pamjaftueshme e përfituar nga skema e Ndihmës Ekonomike bën që individët të sigurojnë të ardhura me mënyra alternative, gjë e cila stimulon krimin

⁴Kjo do të thotë se masa e përfitimit nuk bazohet në kostot minimale të jetesës por në buxhetin në dispozicion që duhet shpërndarë mes përfituesve.

⁵Minimumi jetik është indikator social kryesor, i cili përdoret për vlerësimin e varfërisë dhe cilësisë së jetës, si dhe për llogaritjen e pagave minimale, pensioneve minimale dhe pagesave sociale bazë. Niveli i minimumit jetik në vend njihet si shuma e parave që duhet të zotërojë çdo person për të përballuar nevojat bazë të mbijetesës së tij si qenie njerëzore (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, cituar nga ACER, 2016, fq13).

Minimumi jetik përkufizohet si niveli i të ardhurave i cili garanton që konsumi të përmbushë kërkesat e minimumit të qenieve njerëzore fizike dhe sociale (Avokati i Popullit, 2015, fq. 8-10).

ekonomik.

[...]

C. Vlerësimi i masës së Ndhmës Ekonomike ndihet i nevojës të përcaktohet si standard ligjor për të ndarë pjesën e popullsisë të varfër nga popullsia jo e varfër në shkallë kombëtare, nivel qarku dhe NJQV. Të bazuarit e politikës së re (2014-2018) të skemës së Ndhmës Ekonomike, mbi modalitetin dhe vlerën e saj, tek një vlerësues i “vjetër” dhe i pa korrigjuar me indikatorët e tjerë të varfërisë, tregon qartë për ndryshime joreale dhe mungesë të theksuar transparence të ministrisë lidhur me objektivat dhe targetat që kërkojnë të përmbushin.

[...]

Burimi: Njoftim i KLSH, datë 06.11.2018

Duke u nisur nga këto konsiderata, vlen të përqëndohemi në minimumin jetik si një tregues i "orientuar nga kostot", i cili mund të përdoret për përcaktimin e skemave mbështetëse për shtresat në nevojë përfshirë nxënësit e arsimit bazë.

Llogaritja e minimumit jetik - studim i ACER, 2016

Një ndër studimet më të fundit që kanë hulumtuar përcaktimin e minimumit jetik është realizuar nga Albania Center for Economic Research (ACER), kontraktuar nga institucioni i Avokatit të Popullit. Në këtë studim të realizuar në vitin 2016, grupi i kërkimit të kësaj organizate ka llogaritur minimumin duke përdorur metodën e varfërisë absolute⁶, metodë e konsideruar si më e përshtatshme për vendet relativisht të varfra si Shqipëria.

Formula e thjeshtuar, e përdorur në këtë studim paraqitet më poshtë:

Minimumi jetik = Minimum jetik i shportës së ushqimeve + Minimum jetik i shpenzimeve jo-ushqimore të konsumit

Në llogaritjen e minimumit jetik të shportës së ushqimeve janë konsideruar studime të realizuar nga Food and Agricultural Organization (FAO) për dietën ushqimore, si dhe të dhëna nga INSTAT për çmimet mesatare të vitit 2015.

Tabela 1. Minimumi jetik në vlerë për artikujt ushqimorë në muaj

	Norma ditore në gr.	Norma mujore në kg.	Çmimet mesatare për kg në 2015 ⁷	Vlera mujore në lekë	
1	Bukë dhe brumëra	115.65	3.52	61.9	218
2	Drithëra, miell dhe makarona	263.11	8.00	142.1	1137
3	Mish	20.00	0.61	613.5	373
4	Peshk	2.75	0.08	824.9	69
5	Qumështi dhe produktet e qumështit	100.00	3.04	311.7	948
6	Vaj	39.28	1.19	345.1	412
7	Fruta	18.33	0.56	143.8	80
8	Perimet dhe bishtajoret	707.96	21.53	142	3,058

⁶ Varfëria absolute përcaktohet si një gjendje e karakterizuar nga privimi i rëndë i nevojave themelore të njeriut, duke përfshirë ushqimin, ujin e pijshëm, objektet sanitare, shëndetësinë, strehimin, arsimin dhe informacionin. Ajo varet jo vetëm nga të ardhurat, por edhe nga qasja në shërbime (Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave, faqe 1728).

⁷ Çmimet mesatare për secilin grup ushqimor janë përfutur duke ponderuar çmimet e artikujve ushqimorë bazë të grupit sipas peshave të tyre

9	Sheqer dhe ëmbëlsira	43.41	1.32	535.7	707
10	Erëzat	0.00	0.00	35.6	0
11	Pije joalkoolike, çaj dhe kafe	27.50	0.84	102.5	86
12	Ushqime të tjera	0.13	0.00		0
Totali					7,089

Burimi: ACER, 2016 mbështetur në të dhënat e INSTAT

Për përcaktimin e peshave specifike të kategorive të ndryshme të shpenzimeve janë përdorur të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes të vitit 2014. Rezultoni se shpenzimet për ushqime zenë rreth 44.3% të totalit të shpenzimeve mesatare mujore për konsum, ndërsa pjesa e mbetur, prej 55.7%, janë shpenzime jo-ushqimore (ACER, 2016). Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e konsumit të ndara sipas grupeve përkatëse.

Tabela 2. Shpenzimet mesatare mujore për konsum

Lloji i shpenzimit	Vlera (në %)
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	44,3 44.3%
Pije alkoolike dhe duhan	3,6 55.7%
Veshje dhe këpucë	5,1
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar	10,2
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	5,4
Shëndet	4,8
Transport	6,8
Komunikim	3,3
Argëtim dhe kulturë	3,1
Arsim	4,2
Restorante dhe hotele	3,2
Të tjera mallra dhe shërbime	6,0

Burimi: ACER, 2016 mbështetur në të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes, 2014

Duke konsideruar peshën specifike që zenë shpenzimet e shportës ushqimore kundrejt shpenzimeve të tjera jo-ushqimore, autorët e këtij studimi kanë dalë në konkluzionin se minimumi jetik për frymë për vitin 2015 është 16,000 lekë në muaj.

Tabela 3. Minimumi jetik në vlerë për frymë në muaj

	Vlera (në %)	Lekë në muaj
Minimumi jetik i shpenzime ushqimore	44.3	7,089
Minimumi jetik i shpenzimeve jo-ushqimore	55.7	8,913
Minimumi jetik për frymë		16,002

Burimi: ACER, 2016

Dukshëm, kjo shifër është larg mbështetjes aktuale për familjet në nevojë. Edhe nëse e konsiderojmë minimumin jetik si referencë për përcaktimin e mbështetjes për ndihmën ekonomike, sic veprojnë disa shtete të BE-së, përsëri, kjo e fundit mbetet larg treguesve të tillë. Siç shprehen autorët e këtij studimi, llogaritja e minimumit jetik ka një rëndësi të veçantë pasi përdoret më tepër për të orientuar dhe

politikat, sidomos ato që lidhen me përcaktimin e normën minimale të pensioneve, pagës minimale, ndihmës ekonomike, pagesës së papunësisë, pagesës së paaftësisë dhe numrin e përfituesve për secilën prej tyre (ACER, 2016).

Medoda te tjera të orientuara nga logjika e kostove

Duke u fokusuar në mbështetjen direkte për nxënësit, një *proxy* e përshtatshme për llogaritjen e një mbështetjeje financiare të orientuar nga kostotjanë bursat.

Bursat

Nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera të ngjashme. Buxheti vjetor për bursat miratohet nga MASR dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ndërsa kriteret dhe masa e përfitimit janë të përcaktuara me VKM nr. 753, datë 13.12.2017 të Këshillit të Ministrave (shih kutinë 10).

Këto bursa synojnë nxitjen e regjistrimit dhe ndjekjen e arsimit të kategorive apo drejtimeve të caktuara. Kushtet dhe kategoritë e përfituesve janë të parashikuara në VKM të posaçëm. Aktualisht, bursa përfitojnë nxënësit e familjeve në *kushte të vështira ekonomike* dhe që banojnë larg institucioneve shkollore, nxënësit me *rezultate të shkëlqyera* dhe nxënës me *status të veçantë të tyre apo familjes* (numri i prindërve, paaftësia etj); *sektorin prioritar ekonomik* për të cilën studiojnë.

Kutia 10: Kriteret për përfitimin e bursave

[...]

Nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:

2.1 Sipas kriterit ekonomik:

a) Nxënësit e arsimit parauniversitar që vazhdojnë studimet në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre e që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Nxënësit e arsimit parauniversitar që banojnë në zonat rurale, që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe akomodohen në konvikte publike.

2.2 Sipas rezultateve të arritura:

Nxënësit e arsimit profesional që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta).

2.3 Jashtë kriterit ekonomik:

- a) Nxënës që kanë përfituar statusin e jetimit;
- b) Nxënës që kanë humbur kujdestarinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë;
- c) Nxënës që gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik;
- ç) Nxënës që gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë;
- d) Nxënës fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit e që përfitojnë pension invaliditeti dhe nuk kanë të ardhura të tjera;
- dh) Nxënës të komunitetit rom dhe egjiptian që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;
- e) Nxënës që janë identifikuar dhe trajtuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;

ë) Nxënës, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak

të detyrës.

[...]

Burimi: VKM nr. 753, datë 13.12.2017 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017 – 2018”.

Madhësia e bursës dhe kategoritë e tyre mbështeten në po këtë vendim. Në tabelën e mëposhtme gjenden të paraqitura bursat dhe gjysëm-bursat për nxënësit që frekuentojnë shkollat 9-vjecare dhe të mesme. Masa e bursës shtrihet nga 3,328 deri në 7,017 ALL në muaj.

Tabela 4. Masa e bursës për nxënësit në ALL - viti mësimor 2017-2018

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës mujore në lekë			Financimi	
		ALL për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës	Financimi nga nxënësi/pridër	Financimi nga shteti
1	Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme					
	a) Bursa	6,455	200	6,655	0	6,655
	b) Gjysmëbursa	6,455	200	6,655	3,327.5	3,327.5
	c) Me pagesë	6,455	200	6,655	6,655	0
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive e Arsimit Special					
	a) Bursa	7,017	200	7,217	0	7,217
	b) Gjysmëbursa	7,017	200	7,217	3,608.5	3,608.5
	c) Me pagesë	7,017	200	7,217	7,217	
3	Për nxënësit jetimë	7,017	200	7,217	0	7,217

Burimi: VKM nr. 753, datë 13.12.2017 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017 – 2018”.

Përcaktimi i masës së bursës nisët nga një logjikë e orientuar nga kostot. Siç mund të pritët, peshën kryesore në këtë llogaritje e zenë kostot e ushqimit për nxënësit llogaritur mbi bazën e nevojave energjitike të një individi (shih tabelën 5).

Tabela 5. Kosto financiare për ushqimin e nxënësve për frymë në ditë

Nr.	Emërtimi	Njësa matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Cmimi mesatar në lekë	Vlera ditore në lekë
1	Bukë	Gram	350-400	977	100	35
2	Makarona	Gram	30	107	120	3.6
3	Oriz	Gram	30	109	150	4.5
4	Sheqer	Gram	40	157	100	4
5	Fasule	Gram	30	93	200	6
6	Perime	Gram	130	27	100	13
7	Fruta	Gram	100	42	100	10
8	Vaj	Gram	30	270	180	5.4
9	Gjalpë	Gram	20	152	650	13

10	Mish	Gram	70-80	115	750	52.5
11	Djathë	Gram	25	40	600	15
12	Reçel	Gram	20	93	250	5
13	Vezë	Kokërr	1	42	12.5	12.5
14	Qumësht	Gram	200	98	80	16
15	Patate	Gram	200	170	40	8
16	Nënprodukte mishi	Gram	30	100	400	12
	Kuota ditore			2712		215.5

VKM nr. 753, datë 13.12.2017 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017 – 2018”.

Duke konsideruar kostot e ushqimit dhe ato të veshmbathjeve, është përcaktuar dhe shuma totale e bursave (shih kutinë 11). Qartazi, në ndryshim nga minimumi jetik mjaft prej shpenzimeve të tjera të jetesës nuk janë llogaritur. Megjithatë, ky është ndër rastet e pakta, ku institucione qeveritare kanë aplikuar një logjikë kostoje në përcaktimin e mbështetjes financiare.

Kutia 11: Llogaritja e bursave

[...]

Shpenzimet e parashikuara për mbulimin e kostove për një vit shkollor, për një fëmijë apo nxënës janë mesatarisht 6,655 lekë x 9 muaj (10 Shtator – 10 Qershor sipas udhëzimit të Ministrit përgjegjës për arsimin) =59,895 lekë + 7,000 veshmbathje në vit parashikuar për fëmijët e arsimit special apo fëmijë romë egjiptiane = 66,895 lekë në vit.

Në rastin e fëmijëve me nevoja specifike apo të veçanta në arsimin special, shpenzimet e parashikuara për mbulimin e shpenzimeve të bursave për një vit shkollor, për një fëmijë apo nxënës janë mesatarisht 7,217 lekë x 9 muaj (10 Shtator – 10 Qershor sipas udhëzimit të Ministrit përgjegjës për arsimin) =64,953 lekë + 7,000 veshmbathje në vit parashikuar për fëmijët e arsimit special apo fëmijë romë egjiptiane = 71,955 lekë në vit.

[...]

VKM-ja parashikon disa kriterë për përfitimin e bursave nga ai ekonomik, i cili përfshin dhe kriterin e largësisë së vendbanimit nga shkolla, tek ai i meritokracisë (rezultate të mira në mësim), diskriminimit pozitiv të disa zonave të vendit apo degëve të studimit, etj (shih kutinë më poshtë).

Kutia12: Kriteret e bursave

[...]

Nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:

2.1 Sipas kriterit ekonomik:

a) Nxënësit e arsimit parauniversitar që vazhdojnë studimet në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre e që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Nxënësit e arsimit parauniversitar që banojnë në zonat rurale, që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe akomodohen në konvikte publike.

2.2 Sipas rezultateve të arritura:

Nxënësit e arsimit profesional që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta).

2.3 Jashtë kriterit ekonomik:

- a) Nxënës që kanë përfituar statusin e jetimit;
- b) Nxënës që kanë humbur kujdestarinë prindërore, me vendim gjykatë të formës së prerë;
- c) Nxënës që gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik;
- ç) Nxënës që gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë;
- d) Nxënës fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit e që përfitojnë pension invaliditeti dhe nuk kanë të ardhura të tjera;
- dh) Nxënës të komunitetit rom dhe egjiptian që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;
- e) Nxënës që janë identifikuar dhe trajtuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;
- ë) Nxënës, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

2.4 Sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm, nxënësit që ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional:

- a) Në drejtimet mësimore: bujqësi, veterinari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit.
- b) Me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit: Dibër, Bulqizë, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Librazhd, Gramsh, Kolonjë, Përmet, Skrapar dhe Tepelenë.

[...]

Burimi: VKM nr. 753, datë 13.12.2017 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017 – 2018”.

VKM-ja përcakton dhe përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme. MASR dhe ajo e Financave dhe Ekonomisë përcaktojnë buxhetin duke u mbështetur në informacionin e mbledhur përmes shkollave dhe drejtorive arsimore, ndërsa njësitë e qeverisjes vendore, me vendim të këshillave bashkiake miratojnë dhënien e bursave (shih kutinë 11).

Kutia 13: Roli dhe përgjegjësitë e institucioneve për bursat

[...]

4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në konsultim me institucionet arsimore, hartojnë planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional, që ndjekin vitin e parë akademik 2017-2018 dhe ua dërgojnë njërive bazë të qeverisjes vendore, jo më vonë se data 31 dhjetor i vitit ushtrimor

5. Njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar për to, me vendim të këshillit bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4, të këtij vendimi, duke u dhënë përparësi nxënësve nga shtresat, kategoritë sociale në nevojë, për trajtimin me bursë të plotë. Për kushte ekonomike të barabarta në trajtimin me bursë, prioritet kanë nxënëset vajza. Njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, në pamundësi trajtimi me bursë të plotë, brenda planit të miratuar, mund të trajtojnë/miratojnë për nxënësit dhe gjysmë burse.

[...]

VKM nr. 753, datë 13.12.2017 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017 – 2018”.

Përfituesit e bursave aplikojnë pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore këshilli i të cilës miraton masën e përfitimit me vendim të veçantë. Fondet për bursat sipas kriterëve të kësaj

VKM-je parashikohen në buxhetin e qeverisë qendrore dhe transferohen përmes grantit të kushtëzuar. Përfituesit e marrin masën e ndihmës në llogarinë bankare të tyre apo të prindërve ose nëse janë të akomoduar në konvikt, fondet kalojnë direkt tek këto njësi të cilat janë në varësi të pushtetit lokal. Përveç këtyre bursave për të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore ka një rol alokues, në varësi të politikave lokale dhe fondeve në dispozicion, këshilli bashkiak mund të miratojë akordimin e bursave shtesë nga buxheti i njësisë, krijuar ngatë ardhurat e veta apo fonde të donatorëve.

Mbështetja për familjet në nevojë dhe fëmijët - eksperiencia nga vende të BE-së

Ndihma për fëmijët, si të gjithë përfitimet e përkujdesjes sociale, janë të ndryshme në vende të ndryshme të BE-së. Në shtete të ashtuquajtura "të vjetra" ndihma shkon përtej shifrës së 100 Eurove, ndërsa në shtetet që janë berë rishtas pjesë e bllokut kjo shifër është dukshëm nën 100 Euro.

Më poshtë janë trajtuar disa eksperiencia nga vende të BE-së, të cilat paraqesin një farë ngjashmerie me Shqipërinë për sa i përket zhvillimit ekonomik-social.

Masa e ndihmës dhe kushtëzimet - raste nga vendet e BE-së

Ashtu sikundër masat janë të ndryshme edhe mënyra e llogaritjes, si dhe kushtëzimet ndryshojnë shumë nga njëri vend në tjetrin. Një raport i Komisionit Europian paraqet sesi Bullgaria ofron një ndihmë për shkollimin e çdo fëmije, për familjet me të ardhura nën një kufi të përcaktuar. Kroacia përdor llogaritje të mbështetura në të ardhurat minimale për familje. Mjaft vende të tjera të BE-së dhe jo vetëm, nuk aplikojnë (ose kanë mekanizma për raste disi më të rralla, apo i përfshijnë në skema sociale të tjera) transferta të tilla (EC, 2015). Disa vende aplikojnë procedura të ngjashme me bursat në Shqipëri, shpesh të kushtëzuara nga rezultatet në studime. Siç mund të kuptohet lehtë, tërësia e skemave të mbështetjes financiare për familjet me të ardhura të pakta është e shumëllojshme. Disa nga këto modele mund të shërbejnë si bazë për ravigjimin e një instrumenti të tillë në përshtatje me kushtet e vendit tonë.

Masa e ndihmës është shpesh e mbështetur në mundësitë e buxhetit, pavarësisht paraqitet me terma "tingëllues" që përpiqen t'i referohen konceptit të minimumit jetik. Në Rumani, të gjitha familjet në nevojë mbështeten me ndihmë mbi bazën e një treguesi - Minimumi i të Ardhurave të Garantuara (Guaranteed Minimum Income), i cili llogaritet përmes shumëzimit të indikatorit social (Social Reference Indicator) – një tregues monetar i lidhur me përfitimin e papunësisë - me një vlerë që ndryshon në varësi të anëtarëve të një familje (EC, 2014). Ngjashmërisht, masa e ndihmës sociale në Bullgari është e barabartë me diferencën mes minimumit jetik të diferencuar dhe të ardhurave të personit të muajit pararendës. Minimumi jetik i diferencuar përcaktohet si përqindje e minimumit jetik të garantuar (aktualisht 33 Euro për person). Pavarësisht përdorimit të termit minimum jetik, minimumi jetik i garantuar përcaktohet nga qeveria bullgare mbi bazën e mundësive buxhetore. Madje, indeksimi sipas inflacionit apo rritja e tij nuk janë të përcaktuara qartë (EC, 2014).

Qartazi, logjika e masës së ndihmës ekonomike në këto vende është buxhetore, megjithëse ka përpjekje për ta përafuar atë me koston e jetesës.

Kushtëzimet që lidhin përfitimin e ndihmës ekonomike me shkollimin e fëmijëve janë të ndryshme në vende tëndryshme. P.sh., në Rumani, tërësia e ndihmës sociale kushtëzohet nga frekuentimi i shkollës nga ana e fëmijëve të familjes përfituese, përfshirja në programe pune për komunitetin, etj. Ndërsa, në Bullgari, vetëm pjesa e ndihmës që jepet për fëmijën kushtëzohet nga frekuentimi i shkollës. Më poshtë, (kutia 13) paraqitet në mënyrë specifike sesi përcaktohet masa dhe kushtëzohet minimumi jetik i garantuar në Bullgari.

Minimumi jetik i garantuar - Rasti i Bullgarisë

Në temra konkrete minimumi jetik i garantuar përcaktohet përmes përqindjeve të mëposhtme:

Kutia 14: Përqindjes e ndihmës ekonomike ndaj minimumit jetik të garantuar

Përqindjet përmes të cilave minimumi jetik i garantuar llogaritet duke u mbështetur në minimumit jetik është si më poshtë:

Person i moshuar mbi moshën 75 vjeçdhe që jeton i vetëm: 165%;

Person i moshuar mbi moshën 65 vjeçdhe që jeton i vetëm: 140%;

Person i moshuar mbi moshën 65 vjeç: 100%;

Person që banon me një të rritur tjetër (gruaja apo burri): 66% secili;

Persona nën moshën 65, të cilët jetojnë vetëm: 73%;

Person me aftësi që redukton mundësinë për të punuar me 50% ose më shumë: 100%;

Person me aftësi që redukton kapacitetin për të punuar me 70% ose më shumë: 125%;

Fëmijë në moshë 0-16 vjeç (deri në 20 nëse frekuenton shkollën): 91%;

Fëmijë në moshë 7 deri 16 me më shumë se 5 mungesa të pajustificuara: 30%;

Fëmijë në moshë 7 deri 16 që nuk frekuenton shkollën: 20%;

Fëmijë pa një certifikatë vaksinash: 30%

Jetim ose fëmijë i akomoduar nga një familje birësuese: 100%;

Fëmijë me aftësi permanente: 100%;

Prind i vetëm që përkujdeset për një fëmijë nën moshën 3 vjeç: 120%;

Prind i vetëm që përkujdeset për një fëmijë nën moshën 16 vjeç (deri në 20 nëse është në shkollë): 100%.

Burimi: EC (2014). European Minimum Income Network country report - Bulgaria. Analysis and Road Map for Adequate and Accessible Minimum Income Schemes in EU Member States.

Siç vihet re, kjo politikë dhe praktika e llogaritjes nuk konsiderojnë përcaktimin e ndonjë vlere maksimale. Nga ana tjetër, vlera për anëtar ka vetëm një bazë krahasimi - minimumin jetik të garantuar. Nderkohë, që në vendin tonë, ajo është në varësi të individit të parë në certifikatën familjare (50% në krahasim me individin e parë sipas renditjes së certifikatë dhe 72% në krahasim me individët e tjerë mbi 18 vjeç). Së fundmi, kushtëzimet për përfitimin e ndihmës për fëmijë janë të ndryshme. Në rast se një fëmijë frekuenton në mënyrë të rregullt shkollën, familja përfiton 91% të minimumit jetik të garantuar; nëse bën mungesa përtej një kufiri të caktuar, përfiton vetëm 30%; së fundmi, nëse nuk frekuenton shkollën familja përfiton vetëm 20% të kësaj shifre. Qartazi, kushtëzimi i tërësisë së ndihmës me frekuentimin e shkollës shërben si një nxitës më i fortë për familjet për të bindur fëmijët të mos braktisin shkollën.

Eksperiencia të mbështetjes financiare përmes projekteve

UNICEF-i dhe Observatori në partneritet me MASR kanë mbështetur identifikimin e fëmijëve (6 deri në 8 vjeç), të cilët nuk fillojnë arsimin e detyrueshëm në kohë dhe regjistrimin e tyre në

shkollë. Observatori në zbatim të nismës “Çdo fëmijë në shkollë” ka pilotuar zbatimin e mekanizmave për fëmijët jashtë shkolle në bashkinë e Durrësit. Gjatë zbatimit të projektit, është mbështetur integrimi në shkollë i 3 (tre) fëmijëve jashtë shkolle në këtë bashki, për vitin shkollor 2017-2018. Pas nënshkrimit të Kontratës së Grantit midis Observatorit dhe Bashkisë Durrës, Këshilli Bashkiak Durrës, miratoi përdorimin e fondit për mbështetjen e 3 fëmijëve të identifikuar jashtë shkolle me vendimin nr 490, datë 23.04.2018. Vendimi u bazua në:

- Ligjin 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin nr 9355/2005 “Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar;
- Ligjin nr 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;
- Urdhrin e Përbashkët për miratimin e Rregullores ndërmjet 3 Ministrave, datë 05.01.2015 “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”;
- Kontratën e grantit protokolluar në Bashkinë Durrës me nr 21589 prot., datë 27.12.2017;
- Relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Durrës.

Bashkia Durrës ka realizuar shpërndarjen e grantit tek secili prej fëmijëve, bazuar në vlerësimin e nevojave nga punonjësja e NjMF-së, plotësimi i të cilave ka ndikuar në integrimin e tyre në shkollë. Secili prej përfituesve është shoqëruar nga punonjësja e NjMF-së në Bashkinë Durrës, për të blerë artikujt e nevojshëm për fëmijën.

Nga raportet e monitorimit rezulton se ky mini-projekt ka pasur sukses. Fëmijët frekuentojnë në mënyrë të rregullt shkollën.

Në lidhje me *planifikimin dhe shpërndarjen e Bursave në nivel qendror*, masa e bursave dhe kuotës financiare ushqimore ditore për nxënësit, jepet, respektivisht, sipas pasqyrave nr. 2 dhe nr. 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave (KM) nr. 753, datë 13.12.2017, ku specifikohet se:

- o Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për hyrjet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik, që ndjekin shkollat profesionale, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, për vitin e ri shkollor 2018–2019, të japë 2 100 (dy mijë e njëqind) bursa.
- o Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, për vitin e ri shkollor 2018–2019 të japë 800 (tetëqind) bursa.

Nisur nga nevojat e dërguara nga Njësitë e Qeverisjes Vendore në MASR, është parashikuar dhënia e 800 bursave në vit me nje kosto financiare prej 48 -50 milion lekë për 9 muaj. Këto fonde janë me burim financimi nga buxheti i shtetit për arsimin e më pas sipas kërkesave të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore ato rishpërndahen për të mbuluar bursën mujore të fëmijëve/nxënësve përfitues. Shuma mujore e bursës për fëmijë apo nxënës është në masën 6,655 lekë/ muaj ose 215 lekë/ ditë. Në këtë shumë, 6,455 lekë në muaj shkojnë për mbulimin e shpenzimeve për ushqime, si dhe shuma prej 200 lekë për shpenzime vetjake. Për disa kategori ka dhe një shumë të caktuar vjetore për veshmbathje. Kuota financiare në lekë e veshmbathjes për një vit kalendarik, për fëmijët e arsimit special është 7,000 lekë në vit, për fëmijët romë dhe egjiptianë është 7,000 lekë në vit, si dhe për fëmijët jetimë shuma është 10,000 lekë në vit.

Analizë e alternativave

Duke u mbështetur në analizën e mësipërme rezulton se mbështetja efëmjëve përmes skemave të ndihmës ekonomike nuk është ndërtuar mbi një logjikë të orientuar nga kostot. Të gjitha analizat e realizuara nga institucione të ndryshme, si p.sh., Avokati i popullit (studimi i ACER, 2016), apo KLSH të mbështetura në logjikën e minimumit jetik sugjerojnë pamjaftueshmërinë e masës së ndihmës ekonomike. Nga ana tjetër, analizat e kostove, edhe pse të pjesshme, qëndrojnë në thelb të politikës së mbështetjes së disa kategori studentësh me bursa. Që këtu, mund të identifikojmë dy alternativa kryesore në terma të masës së mbështetjes financiare, të cilat mund ti konsiderojmë si referenca për një politikë të mundshme që mbështet fëmijët që braktisin shkollën për arsye ekonomike - (1) minimumin jetik dhe tregues që derivojnë nga ai dhe (2) bursat për nxënësit.

Analiza e mëposhtme e realizuar duke u mbështetur në katër kriteret të sugjeruara nga literatura (IOB, 2009): (1) fisibiliteti nga pikëpamja ligjore; (2) pranueshmëria politike; (3) fisibiliteti kulturor dhe social; (4) fisibiliteti teknik. Katër kriteret tjerë janë përjashtuar nga analiza si rezultat i mungesës së burimeve në dispozicion dhe aksesit në informacion. Këto janë (1) fisibiliteti administrativ, (2) kosto-efektiviteti, (3) eficientia ekonomike dhe (4) qëndrueshmëria. Arsyet specifike të mos-përfshirjes së tyre janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6. Kriteret të papërfshira në analizë

Kriteri	Shpjegimi i kriterit	Arsyeja e mospërfshirjes
Fizibiliteti administrativ	Shkalla e lehtësisë me të cilën një politikë mund të implementohet (faktorë financiarë dhe menaxherialë)	Autori i këtij studimi nuk ka adresuar çështjen e kapaciteteve administrative të aktorëve institucionale që mund të implementojnë një strategji të tillë. Si pasojë, në kushtet aktuale nuk është e mundur të realizohet një analizë paraprake të alternativave, në funksion të këtij kriteri. Edhe pse analizohen mekanizmat egzistues për disbursimin e një mase përfitimi financiar, ngelen për tu vlerësuar më plotësisht dhe për tu saktësuar rolet dhe përgjegjësitë.
Kosto-efektiviteti	Arritja e qëllimeve të politikës me koston më të ulët	Kosto-efektiviteti nuk është pjesë e këtij raporti, meqenëse është konsideruar vetëm një drejtim i mundshëm për zbutjen e fenomenit të braktisjes - ai i mbështetjes financiare. Ndërhyrje të tjera mund të jenë krahasimisht, më efektive, ose eventualisht, plotësuese. Studime të mëtejshme mund të analizojnë politikën e mbështetjes financiare të krahasuar me politika të tjera.
Eficientia ekonomike	Maksimizimi i dobishmërisë për shoqërinë	Nuk janë realizuar analiza në këtë drejtim për arsye të kufizimeve në burime të projektit studimor.
Qëndrueshmëria	Aftësia e një politike për të ruajtur efektet e saj në periudhën afat-gjatë	Nuk janë realizuar analiza në këtë drejtim për arsye të kufizimeve në burime të projektit studimor.

Duke përdorur katër kriteret e lartpërmendura, rezulton se përdorimi i logjikës së orientuar nga kostot e zbatuar në llogaritjen e **bursave** përbën alternativën më të përshtatshme për përpilimin

dhe implementimin e një politike, në rang bashkie, apo dhe në nivel kombëtar për mbështetjen e fëmijëve jashtë shkolle. *Bursat* në ndryshim nga *minimumi jetik* rezultojnë të jenë të mbështetura nga një kornizë ligjore e konsoliduar dhe si pasojë do mbështeteshin më lehtë nga qeveria apo aktorë të tjerë institucionalë. Nga ana tjetër, aplikimi i minimumit jetik apo treguesve të tjerë derivativë mbështet përdorimin e këtij treguesi në shumë drejtime të tjera të politikave sociale, si pensione, paga minimale, etj. Dukshëm, implikimet buxhetore janë të konsiderueshme dhe me sa duket, aktualisht, të papërbalueshme nga buxheti i shtetit. Krahasimisht, politika e bursave mund të shtrihet vetëm në disa grupe përfituesish të synuar, siç ndodh aktualisht. Njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtën të përzgjedhin përfituesit mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në ligj. Që këtu, shtimi i disa kategorive të bursave mund të jetë një alternativë më e realizueshme dhe lehtësisht e kontrollueshme nga pikëpamja buxhetore (burimeve financiare).

Më poshtë paraqiten vlerësimet për të dy alternativat, për secilin nga kriteret e përzgjedhura (tabela 7).

Tabela 7. Krahasim mes dy qasjeve - minimumi jetik dhe bursat

Kriteri	Shpjegimi i kriterit	Minimumi jetik apo tregues derivativ të tij	Bursat
Fisibiliteti nga pikëpamja ligjore	Konsistencë dhe përshtatshmëri me kornizën kombëtare/lokale	Nuk ka një kornizë ligjore edhe pse shumë organizata po ushtrojnë presion ndaj qeverisë për aplikimin e tij.	Ka një politikë tashmë të konsoliduar, e cila përditësohet dhe zbatohet nga MASR.
Pranueshmëria politike	Pranueshmëria e politikës nga ana e aktorëve që zotërojnë poshtet politik	Ka rezistencë të fortë nga ana e qeverisë për implementimin e këtij treguesi si bazë orientuese për politika sociale.	Një shtrirje, zgjerim të përfituesve të bursave mund të jetë lehtësisht i pranueshëm nga qeveria, dhe nga aktorë të tjerë si pushteti lokal.
Fisibiliteti kulturor dhe social	Konsistencë me traditat kombëtare apo lokale; e pranueshme nga popullata lokale.	Përdorimi i këtij treguesi do gjente mbështetje të konsiderueshme popullore.	Përdorimi i këtij treguesi do gjente mbështetje në rast se instrumentat për implementimin e tij do siguronin barazi trajtimi të qytetarëve.
Fisibiliteti teknik	Prezenca e burimeve dhe kompetencave	Debati ndër vite lidhur me minimumin jetik tregon se mungesa e burimeve qëndron në thelb të tendencës së qeverive për të mos e përfshirë në legjislacion këtë koncept/tregues.	Edhe pse ky raport nuk merr përsipër të trajtojë efektin e aplikimit të një politike të tillë, masa më e vogël dhe ekzistenca e burimeve aktuale lë vend për një vlerësim më pozitiv lidhur me këtë masë krahasimisht me minimumin jetik.

Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzione

Analiza e mësipërme tregon qartë se masa e ndihmës ekonomike për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë, përfshirë shtesën për arsimim është mjaft e vogël krahasimisht me nevojat tyre. Krahasimi i masës së ndihmës, e cila mbështetet në një logjikë buxhetore, kundrejt treguesve të mbështetur në një logjikë kostoje, si p.sh., minimumi jetik, tregon për një diferencë të konsiderueshme në terma mase të ndihmës.

Në Shqipëri, frekuentimi i shkollës përbën kushtëzimin e vetëm për pjesën e ndihmës ekonomike që lidhet me shkollimin. Në kushtet e mungesës së të studimeve të tjera, apo të dhënave sasiore që do të mundësonin analizën e efektit të kushtëzimit në zvogëlimin e fenomenit të braktisjes së shkollës, është e mundur të arsyetohet vetëm duke u mbështetur në një logjikë deduktive. Meqenëse, kjo pjesë e ndihmës (shtesa për shkollimin) është relativisht e vogël në terma mase (vetëm 300 ALL), efekti i kushtëzimit duhet të jetë mjaft i kufizuar.

Mbështetur në rishikimin e literaturës dhe në evidencën e anekdotike të mbledhur, rezulton se ekziston një lidhje korrelative mes ndihmës financiare dhe frekuentimit të shkollës. Gjithsesi, sikundër sugjeruar në literaturë, për një efektshmëri të politikave të tilla, është e domosdoshme që përfitimi financiar të shoqërohet me nisma plotësuese të mbështetjes së familjes e fëmijës dhe bashkërendim të roleve të aktorëve në funksion të referimit të rasteve dhe parandalimit të braktisjes. Në mungesë të të dhënave për një studim në shkallë të gjerë dhe me nivel vlefshmërie dhe besueshmërie të lartë, mund të supozohet me logjikë deduktive se efekti i ndihmës financiare në frekuentimin e shkollës mund të rritet me rritjen masës së saj. Që këtu, përcaktimi i masës mbështetur në një logjike kostoje merr një rendësi të veçantë.

Minimumi jetik dhe treguesit derivativë të tij mund të shërbejnë si referenca të përshtatshme për përcaktimin e masës së ndihmës financiare. Megjithatë, duke konsideruar historikun e debatit mbi minimumin jetik dhe implikimet që ka pranimi i tij në politikat sociale të ndjekura nga qeveria, gjasat e përdorimit të një treguesi të tillë në përcaktimin e masës së mbështetjes financiare për fëmijët jashtë shkolle janë mjaft të vogla.

Një mbështetje financiare e ofruar nga qeveria për grupe të caktuara nxënësish janë **bursat**. Masa e kësaj mbështetje ka një logjikë kostoje, edhe pse masa është më e vogël se ajo e përcaktuar në minimumin jetik, pasi nuk parashikon një sërë shpenzimesh. Aktualisht, politika e mbështetjes së kategorive të nxënësve me bursa është mjaft e konsoliduar dhe përditësuar. Mbështetur në analizën që parashikon përdorimin e disa kriterëve vlerësuese, rezulton se **bursat mund të jenë një politikë më e përshtatshme për mbështetjen e fëmijëve jashtë shkolle apo ata që braktisin shkollën për arsye ekonomike.**

Rekomandime

Sikundër theksuar në seksionin e metodologjisë, ky raport ka një sërë kufizimesh, të cilat dobësojnë forcën përgjithësuese të konkluzioneve dhe si rezultat, atë argumentuese të rekomandimeve për politikë-bërje. Megjithatë, disa prej rezultateve të analizës lejojnë për të diskutuar mbi disa çështje që mund të analizohen më në thellësi dhe që përbëjnë drejtime të

mundshme për politikë-bërje. Rekomandimet e mëposhtme fokusohen vetëm në çështje që lidhen ngushtë me shkollimin e fëmijëve jashtë shkolle, ose ata që kanë braktisur shkollën.

- **Ritja e masës së ndihmës ekonomike në përgjithësi dhe shtesës së pjesës për shkollimin** duhet konsideruar si një objektiv afatgjatë, në mënyrë që të përafthohet me minimumin jetik, apo tregues derivativ të tij. Sigurisht, përmbushja e një objektiv i tillë kërkon aplikimin e një strategjie rritje të shkallëzuar, e cila me shumë gjasa, duhet të shtrihet në një hark kohor dekadash duke qenë kontigjente ndaj burimeve financiare të buxhetit dhe zhvillimeve ekonomiko-sociale të vendit.
- Kushtëzimet për marrjen e ndihmës ekonomike duket se nuk kanë dhënë rezultatet e dëshiruara. Praktikrat e vendeve të BE-së mund të shërbejnë si bazë për ndryshime. Sidoqoftë, përpara se të ndërmerren hapa të tillë, është e nevojshme të analizohen më mirë efektet negative që këto politika mund të kenë. Efektiviteti i kushtëzimeve nuk përben të vetmin parim mbi të cilin mund të përshtaten/ ndryshohen kushtëzimet.
- Rekomandohet **përdorimi i bursave si një instrument për të mbështetur financiarisht fëmijët** (dhe familjet e tyre) që vijnë nga shtresa në nevojë. Nga pikëpamja ligjore, vendime të Këshillit të Ministrave për një mbulim kombëtar nga buxheti i shtetit dhe vendime të Këshillave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për nisma më të kufizuara lokale, janë të mjaftueshme për të zgjeruar gamën e përfituesve. Nga pikëpamja e kushtëzimeve apo aspekteve të tjera procedurale që mund të ndikojnë në implementimin e një politike të tillë, është e nevojshme realizimi i disa kërkimeve të mëtejshme, si dhe monitorimi rigoroz i skemave të tilla. *Baza ligjore ku mbështetet vendimarrja e Këshillit Bashiak*, për fëmijët apo nxënësit përfitues të bursës /kuotës ushqimore mujore përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave (KM) nr. 753, datë 13.12.2017 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017 – 2018”, sa vijon:
 - Nenin 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 2;
 - Nenit 32, të ligjit nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
 - Neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”;
 - Nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit të punës”, të ndryshuar;
 - Nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar;
 - Nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar;
 - Nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;

- Nenit 32, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar;
- **Rritja e masës mujore të bursës** mbështetur në një kostim paraprak të njësisve të vetëqeverisjes vendore për çmimet mesatare të ushqimeve që janë pjesë e bursës ditore të fëmijëve. MASR dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë mbështetur në këto përlllogaritje, mund të rrisin masën mujore të bursës çdo vit sipas indeksit vjetor të ndryshimit të çmimeve të konsumit. Për shembull masa e bursës mujore për studentët në muajin dhjetor 2018 u rrit me 11.2% (nga 8,900 lek në muaj në 10,000 lek në muaj).
- **Trajtimi financiar i nxënësve/ fëmijëve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë mund të realizohet drejtpërdrejtë nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore**, ku nxënësit akomodohen dhe ndjekin studimet. Këto fonde mund të bëhen **pjesë e transfertës së pakushtëzuar** për njësitë e vetëqeverisjes vendore, pasi shuma vjetore që MASR alokon në vit është rreth 50 milion lekë.
- **Projekte pilotë të zbatuar nga njësitë e qeverisjes vendore, organizatat e shoqërisë civile në bashkëpunim me MASR** mund të shërbejnë për të përmirësuar të gjithë kuadrin normativ dhe procedural përpara se politika të kësaj natyre të implementohen në nivel kombëtar.

Referenca

ACER (2016), Llogaritja e minimumit jetik në Shqipëri - Nga Minimumi Jetik si Mbijetesë drejt një Standardi Jetese të Arsyeshëm (aksesuar online ne adres <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/RaportMonitorimi/studimi%20per%20minimumi%20jetik.pdf>).

Burnett, N., Guison-Dowdy, A., and M. Thomas (2013). “A Moral Obligation, An Economic Priority: The Urgency of Enrolling Out of school Children.” Educate A Child.

Ciko, I., (2017), “Mekanizmit financiar për mbështetjen e nxënësve jashtë shkolle dhe atyre në rrezik për braktisjen e shkollës”.

EC (2014). European Minimum Income Network country report - Bulgaria. Analysis and Road Map for Adequate and Accessible Minimum Income Schemes in EU Member States (aksesuar online në adresën: <https://eminnetwork.files.wordpress.com/2013/04/emin-bulgaria-2014-en.pdf>).

EC (2014) European Minimum Income Network country report Romania. Analysis and Road Map for Adequate and Accessible Minimum Income Schemes in EU Member States (aksesuar <https://eminnetwork.files.wordpress.com/2013/04/emin-romania-2014-en.pdf>).

EC (2015) Minimum Income Schemes in Europe. A study of national policies. (aksesuar online <https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=15304&langId=en>).

EC (2015). Conditional cash transfers and their impact on children. (aksesuar online ne adresen: www.ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=14694&langId=en)

IOB (2009). Policy and Operations Evaluation Department of the Dutch Ministry of Foreign Affairs. Evaluation policy and guidelines for evaluations (aksesuar online në adresën <https://www.oecd.org/dac/evaluation/iob-evaluation-policy-and-guidelines-for-evaluations.pdf>).

Ligji Nr. 48/2018 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Maurizio, R., Vázquez, G., (2014), “Argentina: Impacts of the child allowance programme on the labour-market behaviour of adults”, Cepal Reviw 113, p. 115-137 (aksesuar online <https://www.cepal.org/en/publications/37424-argentina-impacts-child-allowance-programme-labour-market-behaviour-adults>)

Mincer, J. (1974). Schooling, Experience and Earnings. National Bureau of Economic Research.

Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020, miratuar me VKM nr 11, datë 11.1.2016.

VKM Nr. 682, datë 29.7.2015, për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjëëve arsimore që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit

Njoftim i KLSH, datë 06.11.2018.

VKM nr. 753, datë 13.12.2017 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017 – 2018”.

Udhëzim, Nr. 4, Datë 17.02. 2017 - “për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 9, datë 08. 05. 2017.

Urdhër i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit, ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Shëndetësisë nr. 2, datë 5.1.2015 Për miratimin e rregullores për zbatimin e

marrëveshjes së bashkëpunimit datë 2.8.2013 “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”.

Unicef (2012). Primary school exclusion and ways to improve inclusion in Madagaskar. (aksesuar online në adresën https://www.unicef.org/madagascar/EXCLUSION-INCLUSION_ENG.pdf).

Ziu, M., (2014), Gjeografia e fenomenit të braktisjes së shkollës, Doktoraturë e Univesitetit të Tiranës (aksesuar online në <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/12/Doktoratura-Majlinda-Ziu-Fakulteti-i-Historise-dhe-i-Filologjise-Departamenti-i-Gjeografise.pdf>)